



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

Numri i lëndës: 2020:921191  
Datë: 30.12.2021  
Numri i dokumentit: 02571438

ARJ nr.102/2021

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Muhamet Rexha dhe Beshir Islami, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, N. M., nga F., kundër të paditurit Komuna Ferizaj, me bazë juridike anulim i vendimit të organit të paditur, duke vendosur lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, të paraqitur nga paditësi për mes përfaqësuesit sipas autorizimit, avokat Qendresa B. Lajçi nga Ferizaj, kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA nr.558/2019 të datës 15.06.2021, në seancën e mbajtur me datë, 29 Dhjetor 2021, merr;

**A K T G J Y K I M**

Refuzohet si e pabazuar kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, e parashtruar nga paditësi N. M. nga F., kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit-Departamenti për Çështje Administrative, AA.nr. 558/2019 të datës 15.06.2021.

**A r s y e t i m i**

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA nr. 558/2019 të datës 15.06.2021, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, N.M., e datës 21.06.2019, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 1380/15, i datës 16.05.2019.

Kundër aktgjykimit të lartë cekur të Gjykatës së Apelit, dhe aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësi për mes përfaqësueses së lartë cekur, në Gjykatë Supreme ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston ligjshmërinë e të njëjtëve për shkak të; cenimit të standardeve ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut, n.6.1 të KEMDLNJ dhe n.2 par.1 të protokollit nr. 7 të KEDLNJ, shkeljes së dispozitave të Ligjit për Konflikte Administrative dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme ta aprovoj si të bazuar kërkesën ndërsa aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës së Apelit, AA nr.

558/2019 të datës 15.06.2021 dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A nr. 1380/15 të datës 16.05.2019, ti ndryshoi, ashtu që padinë e paditësit ta aprovoi si të bazuar dhe të anulohen ,Vendimi me nr. 01. Nr. 159/2-15 i dt. 26.06.2015, i lëshuar nga Kryetari i Komunës z. M.S. dhe Aktvendimi nr. 60052/15 i dt.08.07.2015, i lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm ,Pronë, Gjeodezi dhe Mbrojtje të Mjedisit të K. Ferizaj. Të obligohet e paditura Komuna Ferizaj që në afat prej 30 ditë nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, të lëshoj aktin e ri administrativ me të cilin do të bëjë zbatimin e marrëveshjes –bashkë ujdisë 03 nr. 465-7 të dt. 14.01.2010, ose aktgjykimet e kontestuara të prishen dhe lënda ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje, por gjyqtarit tjetër në procedurë, si në kuptim të nenit 223.1, të LPK-së.

Gjykata Supreme në bazë të nenit 53 të LKA, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe pas vlerësimit të aktgjykimit të atakuar, kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, gjen se;

Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshme të vendimit gjyqësor është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me Vendimin nr. 104/2015 të dt. 18.05.2015, lëshuar nga Zyra-Kabineti i Kryetarit të Komunës Ferizaj, është vendosur që të ekzekutohet Marrëveshja 03 nr. 465-07 e datës 14.01.2010, e arritur në mes të palëve për kompensimin e paluajtshmërisë së shpronësuar në mes të komunës Ferizaj dhe paditësit N. M., si titull ekzekutiv, dhe është obliguar Drejtoria për Kadastër të bëjë ndërrimin e ndryshimeve sipas kësaj marrëveshje. Me Vendimin e kontestuar me padi, 01.nr.159/15 dt. 26.06.2015, lëshuar nga Zyra-Kabineti i Kryetarit të Komunës Ferizaj, shfuqizohet vendimi i më parëm nr. 104/15 i dt. 18.05.2015, për Ekzekutimin e Marrëveshjes 03 nr. 465-07, të dt. 14.01.2010, dhe është Obliguar Drejtoria për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi që ta kthej në gjendjen e më parme evidencën e pronës në regjistrat e të drejtave të pronës së paluajtshme (RDPP), me arsyetim se, gjatë zbatimit janë paraqitur konfuzione juridike dhe se për këto paqartësi juridike kërkohet një analizë e mirëfilltë e çështjes konkrete.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti Administrativ duke vendosur sipas padisë së paditësit me aktgjykimin, A. nr. 1380/15 të datës 16.05.2019, e refuzon kërkesë padinë e paditësit, ndërsa e lenë në fuqi vendimin e kontestuar të organit të paditur nr. 159/2015 i dt. 26.06.2015. Gjykata e Apelit në procedurë ankimore sipas ankesës së paditësit me aktgjykimin e AA.nr. 558/2019 të datës 15.06.2021,e refuzon si të pabazuar ankesën e paditësit, N. M., të datës 21.06.2019, ndërsa e vërteton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Supreme duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, me të cilin është refuzuar ankesa e paditësit dhe është vërtetuar aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë. Qëndrimin juridik të gjykatës së Apelit si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë nga se aktgjykimi i atakuar, nuk është i përfshirë me shkelje sipas pretendimeve të paraqitura si në kërkesë të palës paditëse.

Kolegj i kësaj gjykate vlerëson se gjykatat e instancave më të ulëta, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit të organit të paditur të Komunës Ferizaj, në kuptim të nenit 9 , 44, dhe 49 të LKA-së, dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit për Shpronësim, përkatësisht nenin 15 par.2 dhe nenin 21 par. 1, të këtij ligji ,që e rregullojnë procedurën e kompensimit dhe

vlerësimi të pronës së shpronësuar, me të drejtë kanë vlerësuar se prona e shpronësuar e paditësit sipas vendimit 03 nr. 465-7 të dt. 11.11.2009, duhet të kompensohet në harmoni me dispozitat e cekura të ligjit për shpronësim, sepse në rastin konkret mënyra e llogaritjes së kompensimit sipas ujdisë-marrëveshjes për kompensim 03.nr.465-07 e dt. 14.01.2010, paraqitet si kontestuese nga pala e paditur në kuptim të paqartësive juridike lidhur me kompensimin me ndërrim.

Duke shqyrtuar çështjen sipas objektit të kontestit, shpronësimi i paluajtshmërisë, përkatësisht kompensimi i paluajtshmërisë së shpronësuar, me që në këtë çështje nuk është kontestuese procedura dhe nuk kontestohet vendimi i shpronësimit, por kontestuese në mes të palëve është mënyra dhe lartësia e kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar, kolegji i Gjykatës Supreme vlerëson se, gjykatat e rregullta në procedurë të konfliktit administrativ, nuk kanë kompetencë ligjore që duke vlerësuar ligjshmërinë e një vendimi administrativ, të vendosin lidhur me ligjshmërinë e vendimit në drejtim të kompensimit, apo të vlerësojnë se është i drejtë apo jo në drejtim të lartësisë apo mënyrës së kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar si në rastin konkret, dhe të obligojnë organin e paditur të bëjë ekzekutimin e vendimit apo marrëveshjes lidhur me kompensim të paluajtshmërisë së shpronësuar. Prandaj kolegji vlerëson se me të drejtë nga gjykatat e instancave më të ulëta është vërtetuar vendimi i organit të paditur, i cili nuk është përfundimtar sipas mënyrës së vendosjes lidhur me zbatimin e marrëveshjes 03 nr. 465-07 të dt. 14.01.2010, të lidhur në mes të paditësit dhe palës së paditur dhe nga gjykata e shkallë së parë, organi i paditur është udhëzuar që të veproj sipas dispozitave të Ligjit për Shpronësim nr. 03/ L-139, lidhur me kompensimin e pronës së shpronësuar.

Kolegji i Gjykatës Supreme nga theksimet si më lartë vlerëson se në këtë çështje nëse organi i paditur nuk ekzekuton marrëveshjen e kompensimit dhe nëse nuk ka dakordim të dy anshëm, lidhur me lartësinë dhe mënyrën e kompensimit, pala e pa kënaqur apo pronari i paluajtshmërisë së shpronësuar si në këtë rast paditësi, në kuptim të nenit 216 të Ligjit për Procedurën Jokontestimore nr.03/L-007, mund të fillojnë procedurë gjyqësore me qëllim të caktimit të kompensimit, me të cilin nen përcaktohet se; *“Nëse pjesëmarrësit në procedurën e eksproprijimit(shpronësimit) nuk arrijnë marrëveshje për kompensimin e pa luajtshmërisë së eksproprijuar(shpronësuar),brenda afatit prej dy muaj nga dita kur aktvendimi për shpronësim ka marrë formën e prerë ,organi kompetent administrativ ia dërgon aktvendimin e formës së prerë për eksproprijim ,bashkë me të gjitha shkresat dhe provat për pagimin e shumës së ofruar të kompensimit pronarit ose për depozitimin e saj, në gjykatë në territorin e së cilës gjendet paluajtshmëria e eksproprijuar ,me qëllim të caktimit të kompensimit”*.

Pretendimet e palës paditëse si në kërkesë, se aktgjykimet e atakuara të instancave më të ulëta, janë të përfshirë me shkelje të standardeve ndërkombëtare, shkelje të dispozitave të LKA, të LPA, dhe zbatim të gabuar të drejtës materiale, si dhe theksimet e tjera si në arsyetim të kërkesës se, aktgjykimet e kontestuarra janë kundërtëhënës, kontradiktor me vetveten, dhe me arsyetimin e tyre, andaj nuk janë të drejtë dhe ligjor sepse nuk japin arsye të bazuara në fakte dhe ligj, se nuk i kanë analizuar provat veç e veç të palës paditëse dhe nuk e kanë vërtetuar gjendjen faktike lidhur me rrjedhën e çështjes së kompensimit me organin e paditur etj., Kolegji i Gjykatës Supreme këto pretendime dhe të tjerat si në kërkesë i shqyrtoi në tërësi në baza ligjore dhe i gjen se nuk janë të qëndrueshme në baza ligjore dhe nuk janë me ndikim për të vendosur ndryshe në këtë çështje, sepse në gjykatën e shkallës së parë janë administruar prova të mjaftueshme sipas

pretendimeve të palës paditëse, të cilat pretendime edhe në procedurën ankimore nga gjykata e apelit janë refuzuara si të pa bazuara, ndërsa është aprovuar si i drejtë dhe ligjor vendimi i organit të paditur, me të cilin nuk është vendosur çështja në mënyrë meritore por është anuluar vendimi i më parë i këtij organi lidhur me zbatimin e kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar. Prandaj ashtu si u theksua si më lartë, me që pala paditëse me palën e paditur kanë mosdakordim, lidhur me zbatimin e marrëveshjes së kompensimit të paluajtshmërisë së shpronësuar, për çështjen e caktimit të kompensimit mund ti drejtohen gjykatës së shkallës së parë me kërkesë, në këtë rast gjykatë me kompetencë territoriale, është Gjykata Themelore në Ferizaj, me që paluajtshmëria e eksproprijuar ndodhet në Ferizaj, që në procedurë Jokontestimore, në pajtim me Ligjin për Shpronësim të realizohet kompensimi adekuat.

Nga të gjitha arsyet e më sipërme Gjykata Supreme, konstaton se në këtë çështje administrative-juridike gjykatat e instancave më të ulëta kanë zbatuar drejtë dispozitat ligjore procedurale dhe materiale, kështu që pretendimet në kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm janë të pabazuara dhe jo me ndikim për vërtetimin e një gjendje tjetër nga ajo e vërtetuar nga gjykatat e instancave më të ulëta.

Nga theksimet si më lartë dhe në bazë të nenit 54 par.1, të Ligjit për Konfliktet Administrative, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË  
ARJ nr. 102/2021, me datë 29 Dhjetor 2021

Procesmbajtësi,  
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,  
Ragip Namani